



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr.1002/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Zyhdi Haziri kryesues, Adnan Konoshevcu dhe Rustem Thaqi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidateve për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë, Marigonë Abazi me nr.15 dhe Ilirida Hebibi me nr.12, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Komunën e Vitisë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 të datës 03.11.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.1002/2021 i datës 04.11.2021, e paraqitur nga kandidatet për anëtare e Kuvendit Komunal në Komunën e Vitisë, Marigonë Abazi dhe Ilirida Hebibi, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK),selia në Prishtinë, dega në Viti, kundër vendimit Nr.2948/2021 të datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për Kuvendin Komunal, për shpalljen e rezultatit përfundimtar, me të cilën ka kërkuar që të rinumërohen votat në Vendvotimet nr. 2609D/01R, 2609D/02R,2609D/03R,2601D/1R, 2601D/02R, 2601D/3R, 2601D/4R, 2601D/5R,2601X/3R dhe 2601X/5R.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin me datën 04.11.2021 nga anëtarët për Kuvend Komunal në Komunën e Vitisë, Marigonë Abazi me nr.15 dhe Ilirida Hebibi me nr.12, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK),selia në Prishtinë, dega në Komunën e Vitisë, me të cilën pretendojnë se në vendvotimet 2609D/01R, 2609D/02R, 2609D/03R në Gjylekarë të Vitisë nga 2 klasa ku janë mbajtur votime kanë 18 vota dhe pretendon se ka pasur 25 vota.

Ndërsa në vendvotimet 2601D/1R, 2601D/02R, 2601D/3R, 2601D/4R, 2601D/5R,2601X/3R dhe 2601X/5R në Gjumnazin “Kuvendi i Lezhës” në Viti kanë votuar familjarët e tyre dhe i mungojnë votat e tyre. Në vazhdim thekson se i njëjti rast është edhe në vendvotimin 2601X/3R dhe 2601X/5R në Shkollën e Mesme Profesionale “ Jonuz Zejnullahu” në Viti.

Andaj përmes apelit kanë kërkuar që të bëhet rinumërimi në Vendvotimet 2609D/01R, 2609D/02R,2609D/03R, 2601D/1R,2601D/02R, 2601D/3R, 2601D/4R, 2601D/5R,2601X/3R dhe 2601X/5R sepse konsideron që brenda subjektit juridik, ju janë tjetërsuar votat.

Apeli është i pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtrueset e apelit kërkojnë që ti rinumërohen vendvotimet 2609D/01R, 2609D/02R, 2609D/03R, 2601D/1R, 2601D/02R, 2601D/3R, 2601D/4R, 2601D/5R, 2601X/3R dhe 2601X/5R, në Komunën e Vitisë.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tyre, nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara për mungesë të votave, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime të votave, për faktin se thëniet e saj nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë vetëm të theksuara në apel, gjë që për panelin pritet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit dhe mungesë të votave, andaj pala ankuese nuk i ka argumentuar shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli e parashtruar nga Marigonë Abazi dhe Ilirida Hebibi, nga Subjekti Politik PDK, nuk është i bazuar me asnjë dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.1002/2021 më datë 07.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.